

Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim

Përkthimi i

**Fjalimit të Xhumasë**

të Kalifit të V-të të Xhematit Islamik Ahmedia,

**Hazret Mirza Masrur Ahmedit,**

mbajtur në xhaminë e Baitul Futuh të

Londrës më 14 maj 2004

## Pendimi

Hazuri tha se njeriu është krijuar i dobët dhe është pjesë e natyrës së njeriut që të gabojë. Kjo shfaqet më së shpeshti tek ata që i pasojnë qejfet dhe dëshirat e kësaj bote dhe nuk anojnë nga të kërkuarit falje prej Allahut dhe nuk mundohen ta përmirësojnë dhe reformojnë veten e tyre. Kjo dobësi në njëfarë mase është prezent edhe te njerëzit e devotshëm, madje edhe vetë profetët mund të kenë bërë gabime të vogla. Mesihu i Premtuar a.s. ka thënë se profetët janë shumë të vetëdijshëm rreth këtyre dobësive njerëzore dhe si antidot ata vazhdimisht e lusin Allahun që t'i mbrojë nga gabimet e mundshme. Pra, kur edhe vetë profetët e lusin Allahun vazhdimisht që t'i mbrojë nga gabimet, atëherë ju mund ta merrni me mend se sa e domosdoshme është për njerëzit e thjeshtë që të kërkojnë ndihmën dhe mbrojtjen e Allahut nga gabimet dhe mëkatet e mundshme.

***Istigfar***, do të thotë të kërkuarit falje nga Allahu dhe të kërkuarit e mbrojtjes së Tij. Allahu i Madhërisëm është Falës dhe Mëshirues i madh dhe ka dëshirë t'i falë gabimet e robit të vet nëse ai i lutet Atij. Këtë Allahu e ka përmendur shumë shpesh në Kuranin e Shenjtë. Allahu gjithashtu na ka mësuar edhe lutjet e nevojshme për t'u mbrojtur nga gabimet dhe mëkatet. Nëse e kërkon ndihmën e Allahut, atëherë ju do të jeni të mbrojtur nga gabimet. Allahu në Kuran ka thënë se nëse kërkon falje, do të faleni dhe do të konsideroheni të denjë për Xhenet. Në ajete të tjera, Allahu Ta'ala thotë se Ai i do ata që pendohen dhe kërkojnë falje prej Tij. Për këtë mirësi të Allahut, edhe nëse do ta falënderonim Atë pa pushim gjatë gjithë jetës, nuk do të mjaftonte. Është fatkeqësi e madhe që duke e ditur se Allahu është kaq Falës i Madh, njerëzit të mos kërkojnë falje prej Tij, e të përparojnë në vepra të mira.

Hazret Ebu Musa Ashari r.a. transmeton se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë duke thënë: *'Allahu i Madhërisëm i hap krahët e Tij në mbrëmje për t'i falur ata që kanë bërë mëkate gjatë ditës; dhe i hap krahët e Tij në mëngjes për t'i falur ata që kanë bërë mëkate gjatë natës'*. Allahu Ta'ala do ta vazhdojë këtë praktikë të Tij deri sa të ekzistojnë qiejt dhe toka. Kurrë nuk do të vijë ajo kohë që të ndërpritet ky atribut i Allahut.

Mesihu i Premtuar a.s. thotë se:

*'Të bërit **Istagfar** do të thotë të kërkuarit falje dhe mbrojtje nga Allahu, nga efekti i gabimeve të bëra dhe nga gabimet e mundshme në të ardhmen. Edhe profetët kanë bërë gabime të vogla, e të mos flasim për njerëzit e thjeshtë. Fjala **ghafar** do të thotë të mbulosh diçka. Vetëm Allahu është i Gjithëfuqishëm. S'ka profet apo aulija që mund të pohojë se vetëm duke u mbështetur në fuqitë e tij do të mund ta shpëtojë vetën e tij nga gabimet. Pra, edhe vetë profetët kanë nevojë për ndihmën e Allahut për të qëndruar larg gabimeve, e të mos flasim për njerëzit e thjeshtë'.*

Për të shprehur përlujtjen e tij para Allahut, Profeti i Shenjtë s.a.s., kërkonte vazhdimisht faljen dhe mbrojtjen e Allahut xh.sh. H. Ebu Hurrera r.a. transmeton se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë duke thënë se: *'Beto hem në Allahun, se më shumë se shtatëdhjetë herë në ditë kërkoj falje prej Allahut për gabimet që mund t'i kem bërë'.* Mesihu i Premtuar a.s. duke e komentuar këtë hadith thotë se: *'fjala **istagfar** është fjalë arabe që do të thotë të kërkoj falje nga Allahu për gabimet që i ke bërë dhe mbrojtje nga efekti i gabimeve dhe mëkateve të bëra. Mëkati është helm; pra o Allah, mbrona nga ky helm në të ardhmen. Mbani mend se këto nuk duhet të jenë vetëm fjalë të thata që thuhet me majë të gjuhës, por duhet të burojnë nga thellësia e zemrës, e jo ta bëni shprehi që vetëm t'i përsëritni këto fjalë pavëmendshëm, por të përqendroheni në kuptimin e tyre dhe t'i përsëritni ato me emocione të vërteta'.* Hazuri tha se, duke e komentuar ajetin që e recitova në fillim, Mesihu i Premtuar a.s. ka thënë se: *'Ka njerëz të cilët janë të lindur me disa vese dhe nuk mund t'i largojnë ato me fuqinë e tyre. Por Allahu na ka mundësuar një rrugëdalje. Ato epshe natyrore mund të rregullohen vetëm përmes lutjeve duke kërkuar falje dhe ndihmë prej Allahut. Kur te njeriu paraqiten mendime të tilla negative, atëherë nëse ai kërkon mbrojtjen e Allahut, Allahu do ta mbrojë atë. Nëse ai njeri vazhdon t'i përsërisë këto gabime, por në të njëjtën kohë vazhdimisht kërkon ndjesë prej Allahut, Ai i ndihmon atij dhe e mbron dhe gradualisht ai lirohet nga ajo dobësi. Kjo është ajo që Allahu e ka përmendur në këtë ajet kur thotë; **'fa majja'amal suan'** që do të thotë se kush bën ndonjë vepër të ligë dhe pastaj sinqerisht pendohet dhe kërkon falje prej Allahut, atëherë ai do ta gjejë Allahun Falës të Madh dhe shumë të Mëshirshëm. Ajo që ceket këtu është se bërja e gabimeve është pjesë e natyrës njerëzore dhe se natyra njerëzore nuk është e lirë prej gabimeve. Paralelisht me këtë, është në natyrën e Allahut dhe është atribut i Tij i përhershëm që të falë, dhe Ai është Falës dhe Mëshirues i Madh. Ky kualitet dhe atribut i Allahut është i amshueshëm, dhe Ai e zbaton atë në rastin e secilit që pasi të ketë bërë ndonjë mëkat, pendohet sinqerisht dhe i kthehet Allahut'.*

Hazuri tha se kur dikush bën ndonjë gabim dhe më pas pendohet dhe i vjen turp dhe i përulet Allahut, atëherë Allahu i Madhërishëm i kthehet atij me mëshirë dhe e largon turpin e tij. Mesihu i Premtuar a.s. vazhdon duke thënë : *'Kjo nuk është diçka që ka ndodhur vetëm në të kaluarën por është një atribut i përhershëm i Allahut që gjithmonë tregohet i mëshirshëm ndaj atyre që kthehen të penduar nga Ai, dhe sinqerisht kërkojnë falje prej Tij. Nuk duhet harruar se*

*kushti kryesor për të tërhequr mëshirën e Allahut është qëndrimi i singertë. Nuk do ta shohë mëshirën e Allahut ai i cili qëllimshëm vazhdon në përsëritjen e mëkateve. Allahu e falë vetëm atë i cili me sinjeritet të plotë pendohet për veprat e tij të këqija. Sa herë që një mëkatar kthehet nga Zoti me pendim, Allahu krahëhapur e pranon pendimin e tij dhe e falë atë’.*

Hazret Anas bin Malik transmeton, se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë s.a.s. duke thënë : *‘Kur një njeri pendohet sinjerisht, ai pastrohet nga mëkati i bërë sikur të mos e kishte bërë kurrë atë. Nëse ai kërkon sinjerisht falje prej Allahut, Allahu do ta mbrojë atë nga të përsëriturit e atij gabimi në të ardhmen’.* Pastaj Profeti e recitoi ajetin **‘InnaLlaha juhibuttavabina vajjuhibul mutatahhiin’** që do të thotë se Allahu i do ata që pendohen dhe ata që e mbajnë vetën e tyre pastër. E pyetën Profetin s.a.s.: *‘Cilat janë shenjat e pendimit të vërtetë?’* Ai tha: *‘Shenja e pendimit të vërtetë është kur njeriut i vjen turp për veprën e keqe që e ka bërë’.* Mesihu i Premtuar a.s. vazhdon duke thënë : *“është e vërtetë se kur robi kërkon falje, Allahu e falë atë”* dhe recitoi ajetin e Kuranit: **‘InnaLlaha juhibuttavvabina va juhibul mutatahhiin’**; pra Allahu i do ata që pendohen dhe ata që e mbajnë vetën e tyre të pastër. Njeriu i cili me të vërtetë pendohet, pastrohet plotësisht dhe bëhet i pafajshëm, dhe përmes kësaj njeriu mund të arrijë e të bëhet aulija apo i dashur i Allahut. Pendimi i vazhdueshëm e bën robin të dashur të Allahut dhe Allahu e çon atë përpara dhe i mundëson atij të bëjë vepra të mira; siç ka thënë Allahu se Ai i do ata që pendohen dhe kërkojnë falje prej Tij dhe pastaj e mbajnë vetën larg çdo papastërtie shpirtërore. Pra pendimi i vërtetë është i atillë që e ngritë besimtarin në shkallë të larta shpirtërore dhe e bën atë trashëgimtar të kualiteteve të larta. Prandaj, është thënë se ai person i cili ka kërkuar sinjerisht falje është bërë i dëlirë. Çfarëdo të keqe që ka bërë në të kaluarën, Allahu e ka falur për shkak të pendimit të tij të singertë; dhe pastaj sikur e lidh një kontratë të re me Allahun, që prej atij momenti të hapet një faqe e re dhe e gjithë e kaluara të shlyhet dhe harrohet’. Mesihu i Premtuar a.s. thotë më pas se ; *‘Pas kësaj fara e dëlirësisë hidhet në atë zemër të pastër’.*

Në kohën që po jetojmë jemi të rrethuar me ligësi të panumërta. Ne ahmedianët duhet të mundohemi që kjo farë e dëlirësisë të mbijë dhe të rritet në zemrat tona, kështu që Allahu i Madhërishëm ta pranojë pendimin tonë dhe të na dhurojë pastërtinë dhe dëlirësinë. Për këtë ne duhet ta përgatitim tokën e zemrës sonë, ashtu siç e përgatitë një bujk i zellshëm dhe i kujdesshëm tokën në të cilën do të hedhë farën; dhe kur e mbjell atë dhe ajo mbin, ai kujdeset që të mos ngrejë kokë rreth saj barishte të tjera e t’ia zënë frymën bimës së re. Bujku gjithashtu hedh edhe pesticidet e nevojshme që ta mbrojë bimën e re nga insektet dhe barishtet e dëmshme. Dhe nëse ndonjë barishte e padëshirueshme ka arritur të ngre kokë, ai me kujdes e shkul dhe e largon atë.

Pra, edhe ne gjithashtu duhet të kujdesemi për tokën e zemrës sonë, kështu që fara e pastërtisë dhe e dëlirësisë të mund të mbijë dhe të rritet e shëndoshë. Kur fara e devotshmërisë mbinë dhe fillon të rritet, gjithmonë ka edhe ‘barishte’ të

tjera që mundohen t'ia zënë frymën dhe ta pengojnë rritën e saj. Ky është djalli i cili mundohet ta pengojë rriten dhe përparimin e kësaj bime të pastër në zemrën tonë. Ai gjithashtu mundohet të hedhë farën e tij të së keqes në zemrën tonë. Por, ashtu sikur që kujdeset bujku i mirë për bimën e tij, edhe ju duhet ta mbronni këtë bimë të mirësisë. Ju gjithashtu duhet edhe t'ia siguronni klimën e duhur e cila do t'ia mundësojë që të rritet, të lulëzojë dhe të sjellë frute. Por, asgjë nuk mund të bëhet pa ndihmën e Allahut, pra, ju duhet t'ia luteni Atij për këtë. Nëse do ta bëni këtë, atëherë bima e devotshmërisë do të rritet, do të lulëzojë dhe do të sjellë; frute dhe veprat e devotshme dhe të mira do të bëhen gjithnjë e më të forta dhe të gjitha elementet negative nga zemra juaj do të zhduken.

Hazret Ibne Abas transmeton se e ka dëgjuar Profetin e shenjtë s.a.s. duke thënë se: *'Ai person i cili vazhdimisht kërkon falje prej Allahut, sa herë që atij i ndodh ndonjë fatkeqësi, Allahu ia largon atë fatkeqësi dhe e zëvendëson atë me mirësi prej nga nuk e pret'*.

Në një hadith tjetër, Profeti i shenjtë s.a.s. ka thënë: *'Çka mendoni për atë njeri i cili e ka humbur devenë e tij në shkretëtirë, mbi të cilën kishte të ngarkuar të gjitha furnizimet dhe ushqimet e tij. Kërkon gjithandej por, askund nuk sheh asnjë shenjë të devesë së tij. Më në fund ulet i dëshpëruar dhe i pashpresë; kur papritmas e sheh devenë e tij duke ardhur. Çka mendoni, a do të gëzohej?'* Sahabët thanë: *'O i Dërguari i Allahut, gëzimi i tij nuk do të kishte kufi'*. Pastaj Profeti tha se: *'Allahu i Madhërishëm është edhe më i gëzuar se ky njeri kur e sheh një shërbëtor të Vetin duke u kthyer i penduar'*.

Pra, për një Zot kaq të mëshirshëm, sa shumë dashuri duhet kultivuar në zemrat tona dhe sa shumë duhet të përulemi ndaj vullnetit dhe kënaqësisë së Tij?

Hazret Xhandab transmeton se e ka dëgjuar Profetin e shenjtë duke thënë: *'Ka thënë një njeri duke u betuar në emrin e Allahut, se Allahu kurrë nuk do ta falë filan fistekun. Në atë moment Allahu foli: 'Kush është ai që mund t'ia lidhë duart e mia dhe mund të më pengojë të bëjë diçka që dua? Unë tani po e fal atë njeri'. Në fakt njeriu që i kishte thënë këto fjalë, i kishte humbur të gjitha sevapet e veprave të tij'*.

Pra, ka një mësim të madh për ne në këtë tregim. Nganjëherë disa njerëz, të fryrë nga arroganca e tyre, mendojnë se janë fetarë të mëdhenj dhe shumë të devotshëm dhe fillojnë të flasin për të tjerët me kritika, duke thënë se Allahu do t'ia dënojë ose nuk do t'ia falë. Mbani mend se të falurit dhe të dënuarit është vetëm në duart e Allahut. Nuk është në kompetencat e njerëzve të flasin fjalë të tilla e të përzihen në punët e Allahut. Nëse do ta bëni këtë ju do ta dëmtoni vetëm veten tuaj dhe askënd tjetër.

Transmetohet nga Hazret Ebu Said Khudri se e ka dëgjuar Profetin e Shenjtë s.a.s. duke thënë: *'Ishte një njeri nga popujt e kaluar i cili kishte vrarë nëntëdhjetë e nëntë njerëz. Pastaj, i penduar filloi të pyeste njerëzit që ta udhëzonin te ndonjë njeri i shenjtë. I treguan se në filan vendin rrinte i vetmuar një njeri i shenjtë. Shkoi te ai dhe i tregoi se kishte vrarë nëntëdhjetë e nëntë*

*njerëz dhe e pyeti se a mund të shpresonte se do të falej nga Allahu. Ai i tha se si mund të falet dikush që ka bërë kaq shumë krime? I hidhëruar nga kjo përgjigje njeriu çoi dorë dhe e vrau edhe këtë njeri të 'shenjtë', dhe me këtë e plotësoi numrin e të vrarëve në njëqind. Fill pas kësaj u pendua përsëri për veprën që bëri, dhe filloi përsëri t'i pyeste njerëzit për ndonjë tjetër dijetar. Njerëzit e udhëzuan te një dijetar tjetër. Shkoi te ai dhe i tregoi historinë e vet dhe më në fund e pyeti se a mund të shpresonte se Allahu do ta falte? Ai iu përgjigj se dera e faljes së Allahut kurrë nuk është e mbyllur. Kush mund ta pengojë Allahun nëse ai dëshiron ta falë dikë. Kusht për t'u falur është që të largohesh nga vendbanimi yt dhe të emigrosh në një vend tjetër ku ka njerëz të mirë e të devotshëm të cilët i shërbejnë Allahut. Bashkohu atyre dhe ndihmoju dhe mos u kthe në vendin ku ke jetuar deri tani, sepse ky është një vend i keq. Unë nis ky njeri për të emigruar, por kur arriti përafërsisht në mes të rrugës e zuri vdekja. Për ta marrë erdhën edhe engjëjt e xhehenemit dhe ata të Xhenetit dhe filluan të grindeshin ndërmjet veti. Engjëjt e xhehenemit thoshin se pas aq shumë krimesh që ka bërë ky njeri, natyrisht se vendin e kishte në zjarr. Si mund të falet një njeri me kaq shumë mëkate? Ndërsa engjëjt e mëshirës thoshin se ai ishte penduar sinqerisht dhe vendin e kishte në Xhenet. Në atë moment erdhi një engjëll tjetër të cilin të dy palët e caktuan si gjykatës. Pasi ia treguan problemin ai u tha: Mate distancën prej vendit prej nga po vinte deri këtu; dhe pastaj edhe distancën prej këtu e deri në vendin për ku po emigronte. Kur e matën rrugën panë se ai ishte për pak më afër vendit për ku po emigronte dhe ku ishin shërbëtorët e Allahut me të cilët dëshironte të bashkohej; dhe kështu engjëjt e mëshirës e morën'.*

Kjo tregon se si Allahu i fal njerëzit. Pra, ju duhet të shpresoni në mëshirën e Allahut. Ka edhe një hadith tjetër në të cilin transmetohet se Hazret Muhamedi s.a.s. ka thënë:

*'Ka disa engjëjt të cilët gjithmonë janë në kërkim të atyre që e përkujtojnë Allahun dhe kur e gjejnë ndonjë tubim ku përkujtohet Allahu, e mbulojnë atë tubim me krahët e tyre dhe e lusin Allahun për ta. Kur ata shërbëtorët të Allahut shpërndahen, engjëjt ngjiten në qiell dhe vijnë para Allahut, i Cili i pyet se prej nga po vini. Ata do t'i thonë se ishim me disa robër Tuaj që po të adhuroni, lavdëroni dhe po të luteshin. Allahu do t'i pyes se çka po kërkonin prej meje? Engjëjt do t'i thonë se ata po kërkonin Parajsën Tënde. Allahu do t'i pyes: 'A e kanë parë ata Parajsën Time'? Ata do t'i thonë: 'Jo o Zoti ynë, ata nuk e kanë parë Parajsën Tënde'. Pastaj Allahu do t'u thotë, si do të ishte gjendja e tyre po ta kishin parë Parajsën Time? Engjëjt do të thonë ata po kërkonin mbrojtjen Tënde, o Zoti ynë. Allahu do të thotë se prej kujt po kërkonin mbrojtjen Time? Ata do të thonë se ata po kërkonin mbrojtjen Tënde prej zjarrit Tënd. Allahu do të thotë: 'A e kanë parë ata zjarrin Tim'? Engjëjt do të thonë: 'Jo ata nuk e kanë parë'. Allahu do të thotë: 'Si do të ishte gjendja e tyre po ta shihnin zjarrin Tim'? Pastaj engjëjt do të thonë se: 'Ata po kërkonin faljen Tënde'. Allahu do të thotë: 'Unë i kam falur dhe i kam mbrojtur prej asaj çka po kërkonin'. Pastaj engjëjt do të thonë: 'O Zoti ynë, një njeri mëkatar po kalonte aty pari dhe u ul me ta. Si qëndron puna me të'? Allahu Ta'ala do të thotë se: 'E kam falur edhe*

*atë gjithashtu. Sepse këta njerëz janë të tillë që edhe nëse dikush ulet me ta vetëm kalimthi, nuk do të privohet nga bekimet e Mia'.*

Pra Allahu Ta'ala e fali madje edhe atë njeri i cili rastësisht po kalonte pranë tyre dhe nga kureshtja për të parë se ç'po ndodhte u ul me ta. Zoti e fali sepse lavdërimi dhe madhërimi që po i bëhej Allahut në atë tubim, kishte arritur në veshët e tij. Në xhamitë tona ku shpesh recitohet dhe komentohet Kurani, lexohen dhe komentohen hadithe, etj., duhet të kemi një prani më të madhe të njerëzve. Ne nuk e dimë atë moment se kur Allahu Ta'ala do të na falë. Disa njerëz mendojnë se janë shumë të zënë me punë dhe nuk vijnë as për namazin e xhumasë. E xhumaja është vetëm një herë në javë dhe është e obligueshme për ju që të vini. Besimtari vazhdimisht duhet të jetë në kërkim të rrugëve që çojnë nga Mëshira dhe Falja e Allahut.

Mesihu i Premtuar a.s. thotë se: *'Për rritjen tonë shpirtërore, ne kemi nevojë për ujin shpirtëror që na jepet nga Allahu i Madhërishëm. Vazhdimisht duhet kërkuar ndihma e Allahut për t'u mbrojtur nga gabimet. Uji shpirtëror i cili është i domosdoshëm për rritjen e devotshmërisë sonë është istaghfari (të kërkuarit falje prej Allahut)'. Dikush e luti Mesihun e Premtuar a.s. që të lutej për të që të lirohej nga borxhet. Mesihu i Premtuar a.s. tha se 'Ju duhet ta recitoni istighfarin, se kjo e bën jetën më të lehtë dhe kjo është ajo derë e cila të çon në përparim'. Kështu Mesihu i Premtuar e shpjegoi se për ta mbrojtur veten nga borxhet dhe problemet e tjera, istaghfari është i nevojshëm. Edhe dikush tjetër e luti Mesihun e Premtuar a.s. të lutej për të që Allahu t'i falte fëmijë. Mesihu i Premtuar i tha se: 'Ai duhet të kërkonte falje prej Allahut. Allahu fal dhe dhuron nga Begatitë e Tij'.*

Hazuri thotë se ata që dëshirojnë të kenë fëmijë dhe kërkojnë të lutemi për ta, gjithashtu duhet ta provojnë këtë 'recetë' të Mesihut të Premtuar. Por kusht për këtë është që istighfari të jetë i sinqertë. Shtrohet pyetja se cila është mënyra e drejtë e të kërkuarit falje? Sipas Mesihut të Premtuar a.s.: *'Kur kërkoni falje, nuk duhet t'i recitoni vetëm fjalët e lutjeve që i keni mësuar përmendësh, por me sinqeritet të plotë të luteni edhe me fjalët tuaja'.*

Mesihu i Premtuar më tutje thotë: *'Se vetëm fjalët e thata nuk janë të mjaftueshme, por janë ndjenjat e zemrës suaj ato të cilat Zoti i shikon dhe nëse ato shfaqin pendimin e vërtetë, vetëm ato pranohen prej Tij. Nëse vetëm do ta përsëritni fjalën 'istagfar', kjo nuk do të sjellë asgjë. E vetmja gjë që i përcillet Allahut është pendimi i zemrës suaj. Pra luteni Allahun me fjalët tuaja sepse fjalët tuaja burojnë nga emocionet tuaja. Edhe para se të ketë bërë njeriu ndonjë gabim, duhet të kërkojë ndihmën e Allahut, dhe kur njeriu e bën gabimin atëherë ai kursehet prej shumë të këqijave. Pra, ju duhet gjithmonë t'i luteni Allahut të Gjithëmëshirshëm, dhe nëse do ta bëni këtë, atëherë në kohë të sprovave ju do ta shihni se Allahu do të ju mbrojë'.*

Mesihu i Premtuar a.s. vazhdon duke thënë se: *'Nuk duhet të mendoj dikush se mund të vazhdojë me përsëritjen e mëkateve dhe pas një kohe të gjatë të thotë: 'Tani po kërkoj falje' e të falet nga Allahu. Ju duhet të kërkonit falje menjëherë pasi të keni bërë gabimin. Kjo është sikur me rastin e helmit dhe kundërhelmit. Nëse dikush ka pirë helmin, atij menjëherë duhet t'i jepet kundërhelmi'. 'Po të mos kishte ekzistuar kjo dobësi në natyrën njerëzore, njeriu do të ishte bërë arrogant. Kjo dobësi që është në natyrën njerëzore, e mban njeriun larg arrogancës. Nëse njeriu që ka bërë gabimin, pendohet menjëherë, ai do të pastrohet nga gabimi. Kur njeriu me ngulm e thërret Allahun Ta'ala, më në fund Allahu thotë: 'Mirë po të falë; tani ti je pastruar'. Kjo do të thotë se zemra e atij njeriu është ndryshuar dhe se ai tani e urren të përsëriturit e atij gabimi ashtu sikur që e urren ngrënien e mishit të cofëtinës.*

Nganjëherë bëhen ankesa rreth disa të rinjve se nuk po bashkëpunojnë mjaft me Xhematin, se kanë ngelur prapa në trajnim, se shikojnë programe të ndyta në televizor ose në internet, etj. Nëse ne nuk i vetëdijësojmë fëmijët tanë dhe anëtarët e familjeve tona, nuk mund të ketë shpëtim nga këto sëmundje. Ata që i shikojnë këto programe të ndyta, e dëmtojnë jetën e tyre shpirtërore e bashkë me të edhe gjepin e tyre, sepse shpesh, ato programe duhen blerë.

Mesihu i Premtuar a.s thotë se: *'Njeriu kalon nëpër faza të ndryshme në jetë. Nganjëherë ka shumë zell në adhurim dhe i duket se po fluturon nga Allahu dhe ndjen shumë kënaqësi në namazet e tij. Por, nganjëherë i njëjti njeri kalon nëpër faza të tjera kur ndjen një mungesë vullneti për namaz dhe tregon plogështi në bërjen e veprave të mira. Në këtë gjendje njeriu duhet të kërkojë falje dhe ndihmë nga Allahu. Kjo është e vetmja rrugëdalje nga kjo gjendje. Për të arritur një ndryshim pozitiv në veten tuaj ju duhet të jeni të durueshëm dhe të paluhatshëm në të kërkuarit falje. Nëse do të vazhdoni me të kërkuarit falje prej Allahut, përfundimisht do të vijë ajo kohë kur njeriu do ta arrijë atë ndryshim pozitiv në veten e tij.*

Duke e këshilluar dikë, Mesihu i Premtuar tha se: *'Pesë namazet ditore, nëse bëhen si duhet dhe me përkushtim, janë mjete më të rëndësishme të cilin gradualisht e çon njeriun tek falja e Allahut. Ti duhet të jesh i durueshëm sikur bujku i cili e hedh farën dhe pastaj pret. Nëse do të dëshpërohesh shumë shpejt, do të dështoni. Nëse dikush ka gropuar një bunar për njëzet vjet dhe pak para se të dalë uji ai dorëzohet, i gjithë munda i tij i ka shkuar huq. Është praktika e Allahut të Madhërishtë, që t'ju vështrojë për të parë se sa po mundoheni dhe sa jeni të durueshëm dhe të jeni të sigurt se më në fund Ai e shpërblen mundin tuaj'.*

Kalifi më tutje tha se në ditët tona njerëzit po ballafaqohen me vështirësi të shumta. Gjithandej po mbretëron kaosi dhe korrupsioni. Për çdo ditë një problem i ri e ngre kokën dhe një sprovë e re u del njerëzve përpara. Në këtë kohë ne ahmedianët duhet ta kthejmë vëmendjen e plotë nga lutjet. Ahmedianët mbajnë përgjegjësi të mëdha në supet e tyre. Allahu na dhashë mundësi që ta kuptojmë këtë dhe pastaj të lutemi më vullshëm dhe më me ngulm.

Mesihu i Premtuar a.s. thotë se: 'Zoti juaj është ai Zot, i cili e pranon pendimin dhe i falë shërbëtorët e tij. Askush nuk duhet të mendojë ndryshe. Në një ajet tjetër Allahu gjithashtu thotë se ai njeri i cili e bën edhe krimin më të vogël do të ndëshkohet. Natyrisht se nuk ka kontradiktë në mes këtij dhe ajeteve të tjera. Kjo lloj vepre është ajo të cilën njeriu e përsëritë vazhdimisht pa u penduar. Prandaj fjala 'sherr' është përdorur në këtë fjali e cila tregon ligësinë e atij personi i cili insiston në përsëritjen e atij mëkati dhe nuk dëshiron ta braktisë. Përndryshe i tërë Kurani është përplot ajete ku thuhet se ata që pendohen, Allahu do t'i falë, e madje Allahu i do ata. Pra, nëse njeriu pendohet dhe i vjen turp për veprën që e ka bërë, atëherë Allahu e mbron atë prej pasojave të veprës së ligë. Por njeriu nuk duhet të insistojë me vetëdije. Nëse ai vazhdon me përsëritjen e atyre mëkateve pa u merakosur dhe pa i ardhur keq, atëherë sipas këtij ajeti të Kuranit, Allahu përfundimisht do ta dënojë atë njeri.

Pendimi i vërtetë kërkon një vdekje të jetës së mëparshme mëkatore, në mënyrë që të fillojë një jetë e re. Ai nuk duhet ta ketë më qëndrimin e njëjtë, as gjuhën e njëjtë, as nuk duhet të bëjë të njëjtën jetë që e kanë bërë deri më tani. Ai duhet të duket si një njeri krejtësisht tjetër, i panjohshëm. Kështu duhet të duket i penduari i singertë.

Ju duhet gjithashtu të mundoheni ta mbron veten tuaj nga çdo lloj ligësie dhe mëkati'.

Duhet ta mbron veten nga të gjitha helmet që shoqëria e ditëve tona ju ofron. Shpesh u bie t'i shihni fëmijët e moshës 15-16 vjeç të cilët e zhvillojnë vesin e të pirit duhan, e madje edhe përdorimin e drogës. Të njëjtë që ua sjellin si dhuratë në fillim, fillojnë pastaj t'ua shesin shtrenjtë. Pra, prindërit duhet të jenë vigjilent që ligësi të tilla të mos i prekin fëmijët tanë.

Kalifi pastaj e citoi Mesihun e Premtuar a.s. të ketë thënë: 'Të jeni të sigurt se pendimi sjellë me vete shumë bekime. Shenjtorë dhe aulija të vërtetë janë ata që pendohen. Allahu pastaj i ofron kah vetja e Tij. Ai njeri i cili pendohet plotësisht ngrihet pastaj në shkallë më të lartë shpirtërore dhe të gjitha fatkeqësitë largohen prej tij. Ngrehuni, pra dhe kërkon falje prej Allahut dhe përpquni ta kënaqni Zotin tuaj me veprat tuaja të mira. Është Dita e Gjykimit ajo në të cilën do të vendoset se kush i takon cilës fe, por me siguri mund të themi se ai njeri i cili me vetëdije ngulmon në mëkate, nuk mund ta kënaqë Allahun. Pra përpquni ta kënaqni Zotin tuaj, para se të bëhet tepër vonë dhe para se ajo ditë e trishtueshme të vijë'.

Mesihu i Premtuar i ka përmendur epidemitë e ndryshme të kohës, por, thotë Kalifi, në ditët tona ju mund ta shihni SIDA-në si një nga fatkeqësitë e mëdha. Mesihu i Premtuar ka thënë: 'Para se ajo ditë e trishtueshme të vijë rreth së cilës profetët ua kanë tërhequr vërejtjen njerëzve, kthehuni nga Allahu dhe përpquni para Tij. Ai mund t'i falë mëkatet e shtatëdhjetë viteve. Mos mendoni se Allahu nuk do ta pranojë pendimin tuaj. Do të jenë ndjenjat e zemrës suaj ato që do t'u bëjnë të ngadhënjëni dhe jo veprat tuaja'.

O Allah! Na bëjë neve nga shërbëtorët e devotshëm të cilët përgjithmonë përuken para Teje.

Hazuri tha se nesër, insha'allah do të udhëtoj për në Gjermani për të marrë pjesë në takimin vjetor e të rinjve (Ixhtema Khudam-ul Ahmedia), dhe më pas do të udhëtoj për në Holandë. Ju lus që të luteni për mua që Allahu ta bekojë këtë turne dhe t'i bekojë këto tubime.

This is an Albanian translation of Hazoor's Khutba of **14 May 2004**. The topic of this Khutba is: **Repentance**  
This translation has been prepared by the members of Kosovo Jam'aat.

